



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI KONKURENCËS

VENDIM
Nr. 489, Datë 20.12.2017

Për miratimin e rregullores "Për Kategoritë e Marrëveshjeve të Transferimit të Teknologjisë"

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

- | | | |
|-----------|--------|------------|
| • Juliana | LATIFI | Kryetare |
| • Eduard | YPI | Zv/Kryetar |
| • Koço | BROKA | Anëtar |
| • Iva | ZAJMI | Anëtar |
| • Leida | MATJA | Anëtar |

Në mbledhjen e tij të dates 20.12.2017, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Miratimin e Rregullores "Për Kategoritë e Marrëveshjeve të Transferimit të Teknologjisë", në zbatim të Ligjit nr.9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës"(i ndryshuar);

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.03.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës" (i ndryshuar), neni 6.

Komisioni i Konkurrencës në bazë të nenit 24, shkronja d, të Ligjit nr. 9121, datë 28.03.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", (i ndryshuar), pas shqyrtimit të Projekt-Rregullores "Për Kategoritë e Marrëveshjeve të Transferimit të Teknologjisë" dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm:

VËREN SE:

1. Kjo rregullore sjell sigurimin e konkurrencës efektive dhe siguri ligjore për ndërmarrjet, duke përcaktuar marrëveshjet e transferimit të teknologjisë të cilat përjashtohen nga

ndalimi, vlerësimi i ndikimit të tyre në tregun përkatës si dhe evidentimi i rasteve kur këto lloj marrëveshjesh nuk përjashtohen. Marrëveshjet e transferimit të teknologjisë të lidhura ndërmjet dy ndërmarrjeve që lejojnë prodhimin e produkteve të kontraktuara u njihet e drejta e përjashtimit nga kategoria e marrëveshjeve të ndaluara. Kur ndërmarrjet, palë të një marrëveshjeje, janë ndërmarrje konkurruese, përjashtimi do të zbatohet me kusht që pjesa e kombinuar e palëve në treg të mos tejkalojë 20% të tregut përkatës të prekur. Ndërsa kur ndërmarrjet, palë të një marrëveshjeje, nuk janë ndërmarrje konkurruese, përjashtimi do të zbatohet me kusht që pjesa e tregut e secilës palë të mos tejkalojë 30% të tregut përkatës të prekur.

2. Në mjedisin shqiptar këto marrëveshje do të përmirësojnë efikasitetin ekonomike të ndërmarrjeve, duke qenë se mund të reduktojnë duplikimin e kërkimit dhe zhvillimit, të rrisin nxitjen për kërkime dhe zhvillime fillestare, të nxisin inovacionin në rritje dhe të sjellin konkurrencë në tregun përkatës të prekur.
3. Shkalla e përafrimit të kësaj rregulloreje konsiderohet e Plotë me Rregulloren e Komisionit Europian (BE) nr. 316, datë 21 Mars 2014 "Për zbatimin e nenit 101(3) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian për Kategoritë e Marrëveshjeve të Transferimit të Teknologjisë" (32014R0316) (OJ L 93, 28.3.2014, p. 17–23).

Komisioni i Konkurrencës, pasi shqyrtoi relacionin përkatës,

VENDOSI:

1. Miratimin e Rregullores "Për Kategoritë e Marrëveshjeve të Transferimit të Teknologjisë" sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi;
2. Shfuqizimin e Vendimit nr.179, datë 02.03.2011, të Komisionit të Konkurrencës, për miratimin e rregullores "Për kategoritë e marrëveshjeve të transfertave teknologjike".

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

RREGULLORE

"PËR KATEGORITË E MARRËVESHJEVE TË TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJISË"¹

Kreu I

Dispozita të Përgjithshme

Neni 1

Objekti dhe Qëllimi

Objekt i kësaj rregulloreje është përjashtimi nga ndalimi i kategorive të marrëveshjeve të cilat kanë si objekt ose pasojë transferimin e teknologjisë, në zbatim të nenit 6 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar, (këtu e në vazhdim nr. 9121/2003).

Qëllimi i rregullores është të sigurohet konkurrenca efektive dhe siguri ligjore për ndërmarrjet, duke përcaktuar marrëveshjet e transferimit të teknologjisë të cilat përjashtohen nga ndalimi, vlerësimi i ndikimit të tyre në tregun përkatës si dhe evidentimi i rasteve kur këto lloj marrëveshjesh nuk përjashtohen.

Neni 2

Fusha e zbatimit

1. Kjo rregullore zbatohet për marrëveshjet e transferimit të teknologjisë që lidhen me licencimin e të drejtave të teknologjisë. Këto marrëveshje përmirësojnë efikasitetin ekonomik dhe janë pro-konkurrese, se mund të reduktojnë duplikimin e kërkimit dhe zhvillimit, rrisin nxitjen për kërkime dhe zhvillime fillestare, nxisin inovacionin në rritje, lehtësojnë shpërndarjen dhe sjellin konkurrencë në tregun e produktit. Mundësia që efekte të tilla pro-konkurrese të tejkalojnë efektet anti-konkurrese si pasojë e kufizimeve të mundshme që sjellin marrëveshjet e transferimit të teknologjisë, varen nga shkalla e fuqisë së tregut të ndërmarrjeve në fjalë dhe, për rrjedhojë, nga masa në të cilën këto ndërmarrje, përballen me konkurrencën e ndërmarrjeve që zotërojnë teknologji zëvendësuese ose e ndërmarrjeve që prodhojnë produkte zëvendësuese.
2. Kjo rregullore zbatohet vetëm për marrëveshjet e transferimit të teknologjisë midis licencuesit dhe të licencuarit. Rregullorja zbatohet edhe për këto lloj marrëveshjesh edhe nëse ato përmbajnë kushte që lidhen me më shumë se një nivel tregtimi, për shembull,

¹ Commission Regulation (EU) No 316/2014 of 21 March 2014 on the application of Article 101(3) of the Treaty on the Functioning of the European Union to categories of technology transfer agreements (32014R0316) (OJ L 93, 28.3.2014, p. 17–23)

që i kërkojnë të licencuarit të krijojnë një sistem të caktuar shpërndarjeje duke përcaktuar detyrimet që i licencuari duhet apo mund t'u vendosë rishitësve të produkteve të prodhuara sipas kësaj licence. Kushte dhe detyrime të tilla duhet të përputhen me rregullat e konkurrencës, të zbatueshme për marrëveshjet e furnizimit dhe të shpërndarjes, të përcaktuara nga ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe udhëzimit nr.145/2010 “Mbi vlerësimin e marrëveshjeve vertikale”. Marrëveshjet e furnizimit dhe të shpërndarjes që lidhen midis një të licencuari dhe blerësve të produkteve sipas kontratës së tij, nuk përjashtohen nga kjo rregullore.

3. Kjo rregullore zbatohet vetëm për marrëveshjet në të cilat licencuesi lejon të licencuarin dhe/ose një ose më shumë nga nënkontraktorët e tij të shfrytëzojnë të drejtat e teknologjisë së licencuar, mundësisht pas kërimit dhe zhvillimit të mëtejshëm, nga i licencuari dhe/ose nënkontraktorët e tij, me qëllim prodhimin e mallrave dhe shërbimeve. Ajo nuk zbatohet për licencimin në kontekstin e marrëveshjeve të kërimit dhe zhvillimit, që mbulohen nga rregullorja nr.187/2011 “Për kategoritë e marrëveshjeve të kërimit dhe zhvillimit”, apo për licencimin në kontekstin e marrëveshjeve të specializimit, që mbulohen nga rregullorja nr.190/2011 “Për kategoritë e marrëveshjeve të specializimit”. Po kështu, nuk zbatohet as për marrëveshjet, që kanë për qëllim thjesht riprodhimin dhe shpërndarjen e produkteve softëerike që mbrohen nga e drejta e autorit, pasi këto marrëveshje nuk kanë të bëjnë me licencimin e teknologjisë së prodhimit, por ngjajnë më tepër me marrëveshjet e shpërndarjes. Nuk zbatohet as për marrëveshjet për grumbullimin e teknologjive, që do të thotë, marrëveshje për grumbullimin e teknologjive me qëllim licencimin e tyre të palë të treta, apo për marrëveshje përmes të cilave teknologjia e grumbulluar u licencohet palëve të treta.
4. Në vlerësimin individual të marrëveshjeve sipas nenit 4 të ligjit, duhen marrë në konsideratë disa faktorë, dhe në veçanti struktura dhe dinamikat e teknologjisë përkatëse dhe e tregjeve të produktit.
5. Përfitojnë nga përjashtimi sipas kësaj rregulloreje vetëm ato marrëveshje të cilat përfshihen në nenin 6 të ligjit. Për të arritur përfitimet dhe objektivat e transferimit të teknologjisë, kjo rregullore nuk duhet të mbulojë vetëm transferimin e teknologjisë, por edhe dispozita të tjera që janë pjesë e marrëveshjeve të transferimit të teknologjisë, deri në masën ku këto dispozita lidhen drejtpërdrejtë me prodhimin ose shitjen e produkteve objekt të kontratës.
6. Për marrëveshjet e transferimit të teknologjisë ndërmjet konkurrentëve kur pjesa e kombinuar e palëve në treg nuk tejkalon 20% të tregut përkatës të prekur, dhe nëse marrëveshjet e transferimit të teknologjisë nuk përmbajnë kufizime të ndjeshme antikonkurrese, atëherë këto marrëveshje të transferimit të teknologjisë ndërmjet konkurrentëve mund të supozohet të sjellin përmirësim të prodhimit ose të shpërndarjes, dhe t'i lejojnë konsumatorëve ndarjen e drejtë të përfitimeve rezultuese.
7. Për marrëveshjet e transferimit të teknologjisë ndërmjet jo konkurrentëve kur pjesa e kombinuar e palëve në treg nuk tejkalon 30 % të tregut përkatës të prekur, dhe nëse marrëveshjet e transferimit të teknologjisë nuk përmbajnë kufizime të ndjeshme antikonkurrese, atëherë këto marrëveshje të transferimit të teknologjisë ndërmjet jo-konkurrentëve mund të supozohet të sjellin përmirësim të prodhimit ose të shpërndarjes, dhe t'i lejojnë konsumatorëve ndarjen e drejtë të përfitimeve rezultuese.

8. Nëse kufiri i zbatueshëm i pjesës së tregut tejkalohet për një apo më shumë tregje të produktit apo teknologjisë, atëherë përjashtimi në bllok nuk zbatohet për marrëveshjet për tregjet përkatëse të prekura.
9. Kjo rregullore nuk përjashton marrëveshjet e transferimit të teknologjisë, që përmbajnë kufizime jo të domosdoshme për përmirësimin e prodhimit ose të shpërndarjes. Në veçanti, marrëveshjet e transferimit të teknologjisë, që përmbajnë kufizime të ndjeshme antikonkurruese, si fiksimi i çmimeve që u faturohen palëve të treta, duhet të përjashtohen nga zbatimi i kësaj rregulloreje, pavarësisht pjesëve të tregut të ndërmarrjeve përkatëse. Në rastin e kufizimeve kaq të rënda, kjo rregullore nuk zbatohet.
10. Komisioni shprehet se, kjo rregullore nuk zbatohet për marrëveshjet e transferimit të teknologjisë që përmbajnë kufizimeve specifike në lidhje me tregun përkatës kur rrjete paralele të marrëveshjeve të ngjashme të transferimit të teknologjisë zënë më shumë se 50% të këtij tregu.

Neni 3

Përkufizimi Termave

Në zbatim të kësaj rregulloreje përdoren përkufizimet e mëposhtme:

1. "**Ligj**" nënkupton ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar.
2. "**Marrëveshje**" nënkupton përkufizimin sipas pikës 4, të nenit 3 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar.
3. "**Të drejtat e teknologjisë**" janë njohuri (knoë-hoë) dhe të drejtat e mëposhtme ose një kombinim i tyre, duke përfshirë aplikimet për regjistrimin e këtyre të drejtave: Patentat, modelet e përdorimit, të drejtat e dizajnit, skemat e qarqeve gjysmë-përçues, certifikatat shitesë për mbrojtjen e prodhimeve farmaceutike ose produktet e tjera, për të cilat mund të merren këto certifikata, certifikatat e kultivimit të bimëve dhe të drejtat e autorit mbi softëer-in.
4. "**Marrëveshje për transferimin e teknologjisë**" është marrëveshja e licencimit të të drejtave të teknologjisë, që lidhet ndërmjet dy ndërmarrjeve, me qëllim prodhimin e produkteve kontraktuale nga i licencuari dhe/ose nënkontraktori (ët) i tij, transferimi i të drejtave të teknologjisë ndërmjet dy ndërmarrjeve, me qëllim prodhimin e produkteve kontraktuale, në rastin kur transferuesi vazhdon të mbajë një pjesë të rrezikut, që lidhet me shfrytëzimin e teknologjisë.
5. "**Marrëveshja e ndërsjellë**" është marrëveshja për transferimin e teknologjisë, në të cilën dy ndërmarrje shkëmbejnë me njëra-tjetrën në mënyrë të ndërsjellë, sipas të njëjtës kontratë apo me kontrata të veçanta, licencë për të drejtat e teknologjisë, dhe kur këto licenca u përkasin teknologjive konkurruese, ose mund të përdoren për prodhimin e produkteve konkurruese.
6. "**Marrëveshje jo të ndërsjella**" është marrëveshja për transferimin e teknologjisë, ku një ndërmarrje i jep një ndërmarrjeje tjetër, licencën për të drejtat e teknologjisë, ose kur dy ndërmarrje shkëmbejnë me njëra-tjetrën licenca të tilla, por kur këto licenca nuk u përkasin teknologjive konkurruese dhe nuk mund të përdoren për prodhimin e produkteve konkurruese.
7. "**Produkt**" janë mallrat ose shërbimet, duke përfshirë, si mallrat dhe shërbimet e ndërmjetme ashtu dhe mallrat dhe shërbimet fundore.

8. **"Produkt kontraktual"** është produkti i prodhuar, drejtpërdrejtë apo tërthorazi, nëpërmjet të drejtave të teknologjisë së licencuar.
9. **"Të drejtat e pronësisë intelektuale"** përfshijnë të drejtat e pronësisë industriale, veçanërisht patentat dhe markat tregtare, të drejtat e autorit dhe të drejtat e fqinjësisë.
10. **"Njohuria (knoë-hoë)"** është paketa e informacionit praktik rezultat i përvojës dhe testimëve, që është:
 - i. sekret, që do të thotë jo gjerësisht i njohur ose lehtësisht i aksesueshëm;
 - ii. thelbësor, që do të thotë, i rëndësishëm dhe i nevojshëm për prodhimin e produkteve kontraktuale; dhe
 - iii. i identifikueshëm, që do të thotë i përshkruar në mënyrë të mjaftueshme dhe gjithëpërfshirëse, duke bërë të mundur verifikimin se përmbush kriteret e sekretit dhe të qenit i rëndësishëm;
11. **"Tregu përkatës i produktit"** është tregu për produktet kontraktuale dhe zëvendësuesit e tyre, që do të thotë, të gjithë produktet, që konsiderohen të këmbyeshme apo të zëvendësueshme nga blerësi, për arsye të karakteristikave të produkteve, të çmimeve, dhe të përdorimit të synuar.
12. **"Tregu përkatës i teknologjisë"** është tregu për të drejtat e teknologjisë së licencuar dhe zëvendësuesit e tyre, që do të thotë, të gjitha të drejtat e teknologjisë, që konsiderohen si të këmbyeshme ose të zëvendësueshme nga i licencuari, si pasojë e karakteristikave të të drejtave të teknologjisë, privilegjeve ose qëllimit të përdorimit të tyre.
13. **"Tregu përkatës gjeografik"** është zona, në të cilën ndërmarrjet përkatëse përfshihen në ofertën dhe kërkesën e produkteve ose në licencimin e të drejtave të teknologjisë, ku kushtet e konkurrencës janë mjaftueshëm homogjene dhe mund të dallohen nga zonat fqinje, pasi kushtet e konkurrencës janë qartësisht të ndryshme në ato zona.
14. **"Tregu përkatës"** është kombinimi i tregut përkatës të produktit ose i tregut përkatës të teknologjisë me tregun përkatës gjeografik.
15. **"Ndërmarrjet konkurruese"** janë ndërmarrjet që konkurrojnë në tregun përkatës, që do të thotë:
 - i. ndërmarrjet konkurruese në tregun përkatës, në të cilat licencohen të drejtat e teknologjisë, që do të thotë, ndërmarrje që licencojnë të drejta konkurruese të teknologjisë (konkurrentët aktualë në tregun përkatës),
 - ii. ndërmarrjet konkurruese në tregun përkatës, në të cilat shiten produktet kontraktuale, që do të thotë, ndërmarrje të cilat në mungesë të marrëveshjes për transferimin e teknologjisë, janë aktive në tregjet përkatëse në të cilat shiten produktet kontraktuale (konkurruesit aktualë në tregun përkatës) ose të cilat, në mungesë të marrëveshjes së transferimit të teknologjisë, për motive të justifikuara dhe jo thjesht si një mundësi teorike, ndërmarrin investimet e nevojshme plotësuese ose kosto të nevojshme të shndërrimit në mënyrë që të hyjnë në kohën e duhur në tregun përkatës, në vazhdim të një rritjeje të vogël por të qëndrueshme të çmimeve relative (konkurrentët e mundshëm të tregut përkatës);
16. **"Sistemi i shpërndarjes selektive"** është sistemi i shpërndarjes, në të cilin licencuesi merr përsipër licencimin e prodhimit të produkteve kontraktuale, qoftë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi, vetëm për të licencuarit e përzgjedhur në bazë të kriterëve specifikë, dhe kur këta të licencuar angazhohen të mos ia shesin produktet kontraktuale shpërndarësve të paautorizuar brenda territorit që i rezervohet licencuesit për të operuar sistemin;
17. **"Licencë ekskluzive"** është licenca, sipas të cilës licencuesi nuk lejohet të prodhojë vetë, në bazë të të drejtave të teknologjisë së licencuar, dhe nuk lejohet të licencojë të drejtat e

teknologjisë të licencuar te palë të treta, me qëllim përdorimin e përgjithshëm ose të veçantë, ose në një territor të caktuar;

- 18. "Territor ekskluziv"** është një territor i caktuar, brenda të cilit vetëm një ndërmarrje lejohet të prodhojë produkteve kontraktuale, por ku gjithsesi është e mundur të lejohet edhe një i licencuar tjetër që të prodhojë produkte kontraktuale vetëm për një klient të caktuar, kur këtij të licencuari të dytë i është dhënë kjo e drejtë me qëllim që të krijojë një burimi alternativ të ofrimit për këtë konsumator;
- 19. "Grupi i konsumatorëve ekskluzivë"** është një grup konsumatorësh, te të cilët vetëm njëra nga palët në një marrëveshje për transferimin e teknologjisë është e lejuar të shesë në mënyrë aktive produktet kontraktuale të prodhuara nga teknologjia e licencuar.

Për qëllime të kësaj rregulloreje, termat "ndërmarrje", "licencues" dhe "i licencuar" përfshijnë ndërmarrjet e lidhura respektivisht.

20. "Ndërmarrje të lidhura" janë:

a) ndërmarrjet, në të cilat një palë e marrëveshjes për transferimin e teknologjisë, drejtpërsëdrejti ose tërthorazi:

i. ka më tepër se gjysmën e të drejtave të votës, ose

ii. ka kompetencën për të emëruar më tepër sesa gjysmën e anëtarëve të bordit mbikëqyrës, të bordit drejtues të organeve, që përfaqësojnë ligjërisht ndërmarrjen, ose

iii. ka të drejtën e administrimit të veprimtarisë të ndërmarrjes;

b) ndërmarrjet që gëzojnë, drejtëpërdrejt ose tërthorazi, të drejtat ose kompetencat e renditura në gjermën "a", te njëra nga palët në marrëveshjen për transferimin e teknologjisë;

c) ndërmarrjet, në të cilat ndërmarrja e përmendur në gjermën "b", gëzon, drejtpërdrejt apo tërthorazi, ka të drejtat ose kompetencat të renditura në gjermën "a";

d) ndërmarrjet, në të cilat një palë e marrëveshjes për transferimin e teknologjisë, së bashku me një ose më shumë ndërmarrje të përmendura në gjermat "a", "b" ose "c", ose në të cilat dy ose më shumë nga këto të fundit, gëzojnë bashkërisht të drejtat ose kompetencat e renditura në gjermën "a";

e) ndërmarrjet, në të cilat të drejtat ose kompetencat e renditura në gjermën "a", zotërohen bashkërisht nga:

i. palët në marrëveshjen për transferimin e teknologjisë ose ndërmarrjet e lidhura respektivisht me to, të përmendura në gjermat "a" deri në "d", ose

ii. një ose më shumë palë në marrëveshjen për transferimin e teknologjisë, ose një ose më shumë prej ndërmarrjeve të lidhura respektivisht me to, të përmendura në gjermat "a" deri në "d", dhe një ose më shumë palë të treta.

Kreu II

Përfshirjet dhe Kufizimet

Neni 4

Përfshirja

1. Marrëveshjet e transferimit të teknologjisë të lidhur ndërmjet dy ndërmarrjeve që lejojnë prodhimin e produkteve të kontraktuara, u njihet e drejta e përjashtimit nga kategoria e marrëveshjeve të ndaluara.
2. Përjashtimi zbatohet deri në masën që marrëveshjet e transferimit të teknologjisë përmbajnë kufizime të konkurrencës, të cilat janë objekt i nenit 4 të ligjit nr. 9121/2003, i ndryshuar. Përjashtimi zbatohet për aq kohë sa të drejtat në teknologjinë e licencuar nuk kanë mbaruar apo të jenë deklaruar të pavlefshme ose, në rastin e knoë-hoë, për aq kohë sa knoë-hoë mbetet sekret. Megjithatë, në rastin kur knoë-hoë bëhet publik si rezultat i veprimit të të licencuarit, përjashtimi zbatohet gjatë gjithë kohëzgjatjes së marrëveshjes.
3. Përjashtimi i parashikuar në paragrafin 1 zbatohet gjithashtu për dispozitat, në marrëveshjet e transferimit të teknologjisë, të cilat lidhen me blerjen e produkteve nga i licencuari, ose të cilat lidhen me licencimin apo transferimin e të drejtave të tjera të pronësisë intelektuale ose knoë-hoë të i licencuari, deri në masën që këto dispozita lidhen drejtpërsëdrejti me prodhimin ose shitjen e produkteve kontraktuale.

Neni 5

Kufijtë e pjesës së tregut

4. Kur ndërmarrjet, palë të një marrëveshjeje, janë ndërmarrje konkurruese, përjashtimi i parashikuar në nenin 4 të kësaj rregulloreje, do të zbatohet me kusht që pjesa e kombinuar e palëve në treg të mos tejkalojë 20% të tregut përkatës të prekur.
5. Kur ndërmarrjet, palë të një marrëveshjeje, nuk janë ndërmarrje konkurruese, përjashtimi i parashikuar në nenin 4, do të zbatohet me kusht që pjesa e tregut e secilës palë të mos tejkalojë 30% të tregut përkatës të prekur.

Neni 6

Zbatimi i kufijve të pjesës së tregut

1. Për qëllime të zbatimit të kufijve të pjesës së tregut, sipas nenit 5 të kësaj rregulloreje, zbatohen rregullat e mëposhtme:
 - a) pjesa e tregut llogaritet në bazë të të dhënave të vlerave të shitjeve në treg, dhe nëse të dhënat e vlerave të shitjeve në treg mungojnë, mund të përdoren vlerësimet e bazuara në informacione të tjera të besueshme të tregut, duke përfshirë edhe të dhëna mbi volumin e shitjeve në treg, për të përcaktuar pjesët e tregut të ndërmarrjes në fjalë;
 - b) pjesa e tregut do llogaritet në bazë të të dhënave që lidhen me vitin paraardhës kalendarik;
 - c) vlera e tregut e zotëruar nga ndërmarrja, e përmendur në nenin 3 të kësaj rregulloreje, ndahet në mënyrë të barabartë mes ndërmarrjeve që kanë të drejtat ose kompetencat e renditura sipas këtij neni.

2. Pjesa e tregut e licencuesit në një treg përkatës, për të drejtat lidhur me një teknologji të licencuar, llogaritet në bazë të ekzistencës së të drejtave në teknologjinë e licencuar në tregjet përkatëse (pra tregjet e produktit dhe tregjet gjeografike) ku shiten produktet kontraktuale, pra në bazë të të dhënave të shitjeve për produktet kontraktuale të prodhuara në mënyrë të kombinuar nga licencuesi dhe të licencuarit e tij.
3. Nëse pjesa e tregut e përmendur në nenin 5, paragrafi 1 ose 2, fillimisht është më pak se 20% apo 30% përkatësisht, por rritet në vazhdim mbi këto nivele, atëherë përjashtimi i parashikuar në nenin 4 të kësaj rregulloreje, do të vazhdojë të zbatohet për një periudhë prej dy vitesh kalendarike të njëpasnjëshme, pas vitit në të cilin kufiri prej 20% ose 30% është tejkaluar për herë të parë.

Neni 7

Kufizimet e rënda

1. Kur ndërmarrjet, palë në një marrëveshje, janë ndërmarrje konkurruese, përjashtimi i parashikuar në nenin 4 të kësaj rregulloreje nuk zbatohet për marrëveshjet, të cilat, direkt ose indirekt, veçmas ose në kombinim me faktorë të tjerë nën kontrollin e palëve, kanë si objekt të tyre si vijon:
 - a. kufizimin e mundësisë së një pale për të përcaktuar çmimet e saj kur shet produkte tek palë të treta;
 - b. kufizimin e prodhimit, përveç kufizimeve në prodhimin e produkteve kontraktuale, që i janë vendosur të licencuarit në një marrëveshje jo të ndërsjellë ose që i janë vendosur vetëm njërit prej të licencuarve në një marrëveshje të ndërsjellë;
 - c. shpërndarjen e tregjeve ose e klientëve, me përjashtim të:
 - i. detyrimit të licencuesit dhe/ose të licencuarit, në një marrëveshje jo të ndërsjellë, për të mos prodhuar sipas të drejtave për teknologjinë e licencuar brenda territorit ekskluziv të rezervuar për palën tjetër dhe/ose për të mos shitur në mënyrë aktive dhe/ose pasive në territorin ekskluziv ose për grupin e klientëve ekskluzivë të rezervuar për palën tjetër.
 - ii. kufizimit, në një marrëveshje jo të ndërsjellë, të shitjeve aktive nga i licencuari në territorin ekskluziv apo ndaj një grupi klientësh ekskluzivë që licencuesi ia ka caktuar një të licencuari tjetër, kur ky i fundit nuk ka qenë ndërmarrje konkurruese e licencuesit në kohën e lidhjes së marrëveshjes së licencës së tij.
 - iii. detyrimit të të licencuarit për të prodhuar produktet kontraktuale vetëm për përdorim vetjak, vetëm nëse të licencuarit nuk i kufizohet shitja aktive dhe pasive e produkteve të kontraktuara si pjesë këmbimi për produktet e tij.
 - iv. detyrimit të të licencuarit, në një marrëveshje jo të ndërsjellë, për të prodhuar produkte kontraktuale vetëm për një klient të caktuar, të cilit i është dhënë licenca, për të krijuar një burim alternativ të ofrimit për këtë klient.
 - d. kufizimi i mundësisë së të licencuarit për të shfrytëzuar të drejtat e tij në teknologji apo kufizimi i mundësisë të secilës nga palët në marrëveshje, për të kryer kërkim dhe zhvillim, vetëm nëse ky kufizim i fundit është i domosdoshëm për të parandaluar nxjerrjen e know-how të licencuar te palët e treta.

2. Kur ndërmarrjet, palë në marrëveshje, nuk janë ndërmarrje konkurruese, përjashtimi i parashikuar në nenin 4 të kësaj rregulloreje nuk zbatohet për marrëveshje të cilat, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, veçmas ose në kombinim me faktorë të tjerë nën kontrollin e palëve, kanë si objekt të tyre secilën nga më poshtë:
 - a. kufizimin e mundësisë së një pale për të përcaktuar çmimet e saj kur shet produktet te palët e treta, pa cënuar mundësinë për të vendosur një çmim maksimal shitjeje apo për të rekomanduar një çmim shitjeje, me kusht që kjo të mos jetë e njëjta shumë me një çmim shitjeje të fiksuar ose minimal, si rezultat i një forme presioni ose stimuljeve të ofruara nga ndonjë prej palëve;
 - b. kufizimin e territorit në të cilin, apo të konsumatorëve të cilëve, i licencuari mund t'u shesë në mënyrë pasive produktet e kontraktuale, përveç;
 - i. kufizimit të shitjeve pasive në një territor ekskluziv apo ndaj një grupi klientësh ekskluziv të rezervuar për licencuesin;
 - ii. detyrimit për të prodhuar produkte kontraktuale vetëm për përdorim vetjak, me kusht që i licencuari të mos jetë i kufizuar në shitjen aktive apo pasive të produkteve kontraktuale, si pjesë këmbimi për produktet e tij;
 - iii. detyrimit të të licencuarit për të prodhuar produktet kontraktuale vetëm për klientë të caktuar, kur licenca i është dhënë për të krijuar një burim alternativ të ofrimit për atë klient;
 - iv. kufizimit të shitjeve tek përdoruesit fundorë nga një operator i licencuar në nivelin e tregut të shitjes me shumicë;
 - v. kufizimit të shitjeve tek shpërndarësit e paautorizuar, nga anëtarë të sistemit përzgjedhës të shpërndarjes;
 - c. kufizimit të shitjeve aktive apo pasive te përdoruesit fundorë nga një i licencuar, i cili është anëtar i sistemit përzgjedhës të shpërndarjes dhe që operon në tregun e pakicës, pa cënuar mundësinë për të ndaluar një anëtar të sistemit që të operojë jashtë një vendi të paautorizuar.
3. Kur ndërmarrjet, palë në një marrëveshje, nuk janë ndërmarrje konkurruese në momentin e lidhjes së marrëveshjes, por bëhen ndërmarrje konkurruese më pas, zbatohet paragrafi 2, dhe jo paragrafi 1 i këtij neni, për të gjithë kohëzgjatjen e marrëveshjes, me përjashtim të rastit kur marrëveshja ndryshohet më pas, në mënyrë thelbësore në çdo aspekt material. Një ndryshim i tillë përfshin lidhjen e një marrëveshjeje të re të transferimit të teknologjisë, ndërmjet palëve, për sa i përket të drejtave në teknologjinë konkurruese.

Neni 8

Kufizime të tjera që nuk përjashtohen

1. Përjashtimi i parashikuar në nenin 4 të kësaj rregulloreje nuk zbatohet për asnjë nga detyrimet e mëposhtme, të përfshira në marrëveshjet e transferimit të teknologjisë:

- a.** çdo detyrim i drejtpërdrejtë apo i tërthortë mbi të licencuarin, për të dhënë një licencë ekskluzive apo për transferuar të drejta, tërësisht apo pjesërisht, të licencuesit apo të një palë e tretë, me qëllim që ai të bëjë përmirësimet e veta në teknologjinë e licencuar ose të zbatojë në një mënyrë të re, të vetën, teknologjinë e licencuar;
- b.** çdo detyrim i drejtpërdrejtë apo i tërthortë që i vendoset një palë për të mos vënë në dyshim vlefshmërinë e të drejtave të pronësisë intelektuale që pala tjetër zotëron në treg, pa cenuar mundësinë, në rastin e një licence ekskluzive, e të zgjidhjes së marrëveshjes së transferimit të teknologjisë në rast se i licencuari do të vërë në dyshim vlefshmërinë e çdo të drejte në teknologjinë e licencuar.
- 2.** Kur ndërmarrjet, palë në marrëveshje, janë ndërmarrje konkurruese, përjashtimi i parashikuar në nenin 4 të ligjit, nuk zbatohet për detyrime të drejtpërdrejta apo të tërthorta që kufizojnë mundësinë e të licencuarit për të shfrytëzuar të drejtat e tij në teknologji apo që kufizojnë mundësinë e ndonjërit nga palët në marrëveshje për të kryer kërkim dhe zhvillim, me përjashtim të rastit kur ky i fundit është i domosdoshëm për parandalimin e nxjerrjes së know-how të licencuar të palët e treta.

Neni 9

Revokimi në rastet individuale

- 1.** Komisioni mund të revokojë përfitimet e dhëna sipas kësaj Rregulloreje, kur zbulon se në një rast të veçantë, marrëveshja e transferimit të teknologjisë në të cilën përjashtimi i dhënë sipas nenit 4 të kësaj rregulloreje, zbatohet pavarësisht se ka efekte të cilat janë të papajtueshme me nenin 5 të ligjit, dhe në veçanti kur:
- a.** aksesit në treg i teknologjive të palëve të treta është i kufizuar, për shembull nga një efekt grumbullues i rrjeteve paralele të marrëveshjeve të ngjashme kufizuese, që ndalojnë të licencuarin të përdorë teknologji të palëve të treta;
- b.** aksesit i të licencuarve të mundshëm në treg është i kufizuar, për shembull nga një efekt grumbullues i rrjeteve paralele të marrëveshjeve të ngjashme kufizuese, që i ndalojnë licencuesit nga licencimi i të licencuarve të tjerë apo sepse i vetmi pronar i teknologjisë që licencon të drejtat përkatëse të teknologjisë nënshkruan një marrëveshje ekskluzive licencimi me një të licencuar aktiv në tregun e produktit, në bazë të të drejtave të zëvendësueshme të teknologjisë.
- 2.** Në rastet kur, një marrëveshje e transferimit të teknologjisë për të cilën është dhënë përjashtimi i parashikuar në nenin 4 të Rregullores, ka efekte të cilat janë në kundërshtim të nenit 5 të ligjit, Komisioni i Konkurrencës mund të revokojë përfitimet e dhëna më parë në zbatim të kësaj rregulloreje, sipas përcaktimeve në paragrafin 1 të këtij neni.

Kreu III

Dispozita përfundimtare

Neni 10

Shfuqizime

Rregullorja “Për Kategoritë e Marrëveshjeve të Transfertave Teknologjike”, miratuar me Vendimin nr.179, datë 02.03.2011, të Komisionit të Konkurrencës shfuqizohet.

Neni 11

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.